

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Republika Çeke dhe objektivat e NATO-s
ADRESA	https://dosja.al/bota/republika-eke-dhe-objektivat-e-nato-s-i516429
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 06:30:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d45d6817ff9133c60457494601e5d43c64de052904e17086e42ceb90c70106f5
TEKSTI	1e61f487d9bd32d616b59ab8d981828895ef587ec022959e5812f1dbe3b24485
PAMJA	0abac5b5875aac7746c240060df79842c9d0f1df1fe6152e9a63bb7150e20736

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b08e510e84549004bb6eeff044f6dcd8fae6d24becaeb0f2b9247f8864e527f3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b08e510e84549004bb6eeff044f6dcd8fae6d24becaeb0f2b9247f8864e527f3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

16 ORE ME PARE

Kryeministri anuloi konferencën me gazetarët, Berisha: Kapitullim pa kushte i Ramës. Bardhi: Përgjegjësia nuk shmanget

18 ORE ME PARE

Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

1 DITE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

Bota

Republika Çeke dhe objektivat e NATO-s

Republika Çeke, Sllovenia dhe Shqipëria ende nuk e kanë arritur objektivin e vjetër.

dosja

28 Shtator 2026, 08:21
Nga E.d



Foto ilustruese

Republika Çeke duhet të mbetet e përkushtuar ndaj rritjes së shpenzimeve për mbrojtjen, kërkoi javën e kaluar në Pragë Matthew Whitaker, i dërguari amerikan në NATO. "Ne presim që aleatët tanë të bëjnë më shumë", tha ai.

Kjo kërkesë nuk është diçka e re. Ndërsa paralajmërimet për kërcënimin që vjen nga Rusia po shtohen dhe Uashingtoni kërkon që aleatët evropianë të marrin më shumë përgjegjësi për sigurinë, NATO-ja e ka rritur objektivin e saj për shpenzimet e mbrojtjes nga 2% në 3.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Si pasojë presioni ndaj vendeve që mbeten prapa në realizimin e këtij qëllimi po rritet.

Republika Çeke, Sllovenia dhe Shqipëria ende nuk e kanë arritur objektivin e vjetër. Megjithatë kryeministri çek Andrej Babiš, qeveria e të cilit e uli buxhetin e mbrojtjes për vitin 2026 në rreth 1.7% të PBB-së pasi mori detyrën në fund të vitit të kaluar, i kundërshtoi kritikën e fundit nga Uashingtoni.

Duke ritheksuar se anëtarësimi në NATO është më rëndësi thelbësore për Republikën Çeke, kryeministri deklaroi hapur se qeveria nuk ka mundësi financiare të përshpejtojë rritjen e shpenzimeve ushtarake. Ai është zotuar të arrijë objektivin prej 2% në vitin 2027, por nuk planifikon rritje të mëtejshme përtej këtij niveli.

Miliardi populist shpreson tani se marrëdhënia e tij personale me presidentin amerikan Donald Trump do ta mbrojë vendin mes përplasjes në rritje mbi këtë çështje.

Paralajmërimet për një kërcënim në rritje

Nëse Trumpi do ta mbrojë Republikën Çeke nga kërcënimet e luftës hibride ruse që synon aleatët e NATO-s në Evropën Qendrore, kjo mbetet një çështje tjetër.

Një valë gjithnjë e më e madhe dronësh që devijojnë nga kursi, si dhe operacione sekrete ruse, përfshirë shpërthime të dyshuara, sabotime dhe sulme kibernetike, kanë shtuar shqetësimin në rajon.

Gjermania dhe Polonia, partnerë kyç të Republikës Çeke, kanë raportuar incidente të profilat të lartë dhe i kanë lidhur ato me përpjekje për të frikësuar vendet që mbështesin Ukrainën. Republika Çeke duhet ta kuptojë këtë kërcënim më mirë se shumica e vendeve të tjera, pasi ishte ndër të parat që përjetoi një sulm të tillë.

editoriale

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 08:26

Analiza: Pse nuk flitet për viktimat e krimeve të luftës?

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 07:33

Arrestimi i Vlora Hysenit, mbledhet sot Këshilli i Sigurisë Kombëtare

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 07:12

Protestat kundër qeverisë/ Gazeta gjermane: A do të jetë i rrezikshëm Revolucion i Flamingo për Edi Ramën?

Shërbimi Informativ i Sigurisë i Çekisë (BIS) raportoi në vitin 2021 se shpërthimi i një depoje armësh, ku ruheshin armë të destinuara për Ukrainën, ishte kryer nga Shërbimi Federal i Sigurisë së Rusisë (FSB).

Babiš, i cili në atë kohë ishte në mandatin e tij të parë si kryeministër, reagoi duke dëbuar rreth 100 diplomatë dhe punonjës të ambasadës ruse, duke ngrirë marrëdhëniet me Moskën.

BIS vazhdon të jetë në të njëjtën linjë me agjencitë e tjera sekrete në rajon, duke paralajmëruar se kërcënimi nga Rusia po rritet. Megjithatë, ashtu si qeveritë paraardhëse, edhe qeveria e Babišit nuk ka arritur të ecë me të njëjtin ritëm në rritjen e buxhetit kombëtar të mbrojtjes, ndërsa vendet fqinje kanë ndërmarrë hapa shumë më të shpejtë.

Praga shpenzoi vetëm 1.86% të PBB-së për mbrojtjen vitin e kaluar; ndërsa Polonia dhe shtetet baltike e kanë arritur tashmë objektivin e ri të NATO-s dhe synojnë që vitin e ardhshëm të arrijnë nivelin prej 5% të PBB-së.

Prioritetet e Pragës

Babiš e ka bërë të qartë se kjo qasje nuk do të ndryshojë. Megjithatë pretendimi i tij se Republika Çeke nuk mund të përballojë rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen bie në kundërshtim me buxhetin për vitin 2027, të cilin qeveria e tij e miratoi më 22 shtator.

Plani fiskal parashikon një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve dhe synon deficitin e dytë më të lartë në historinë e Republikës Çeke, në vlerën e 386 miliardë korona (15.8 miliardë euro).

Ndërsa arritja e objektivit të vjetër të NATO-s do të përbëjë një pjesë të këtyre shpenzimeve, pjesa më e madhe e rritjes së buxhetit pasqyron prioritetet e brendshme politike të qeverisë së koalicionit.

Plani reflekton qartë premtimet elektorale të partisë ANO të Babišit dhe të partnerëve të saj më të vegjël, partisë së ekstremit të djathtë Liri dhe Demokraci e Drejtpërdrejtë (SPD) dhe partisë së djathtë radikale Motoristët për Vetën. Të gjitha këto parti argumentojnë se shpenzimet për mbrojtjen nuk duhet të pengojnë nevojën urgjente për investime në pensione, arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë.

"Pretendimi se vendi nuk mund të shpenzojë më shumë për mbrojtjen lidhet kryesisht me politikën e brendshme," tha për DW Aleš Michal, politolog në Universitetin Charles të Pragës. "Prioriteti kryesor është investimi në sistemin social."

Kjo qasje pritet të përkrahet nga mbështetësit e partive në pushtet, të cilët janë kryesisht të moshuar dhe me të ardhura më të ulëta, si dhe shpesh shprehin pakënaqësi për mbështetjen që po u jepet rreth 300 mijë refugjatëve ukrainas.

"Asnjë nga partitë qeverisëse nuk u premtoi votuesve rritje të shpenzimeve për mbrojtjen", kujton Michal, duke iu referuar fushatës zgjedhore të vitit të kaluar.

Megjithatë kritikët thonë se kjo ndodh sepse qeveria po e minimizon kërcënimin që vjen nga Rusia. Zëdhënësi i qeverisë nuk iu përgjigj një kërkesë për koment.

"Ne nuk duam Luftën e Tretë Botërore"

Hezitimi për të rritur shpenzimet e mbrojtjes pasqyron gjithashtu narrativat politike rreth luftës në Ukrainë. Dy ditë pas kritikave të Whitakerit, Babiš u shfaq në një video i veshur me një bluzë ku shkruhej "No War" me shkronja blu dhe të verdha. Ndërsa pranoi ekzistencën e kërcënimit rus, ai bëri thirrje për përpjekje më të mëdha për arritjen e paqes.

"Ne nuk duam Luftën e Tretë Botërore, apo jo?", deklaroi ai, duke përsëritur pretendimin e tij se Evropa duhet të punojë më shumë për t'i dhënë fund konfliktit.

Kjo ishte një paraqitje që pasqyronte qëndrimet e së djathtës radikale evropiane dhe që ka bërë që kryeministri çek të etiketohet si "pro-rus" në disa media ndërkombëtare.

Megjithatë realiteti është më i zakonshëm. Babiš konsiderohet një pragmatist. Elektorati i partisë ANO ka prirje populiste dhe shpesh mban qëndrime kritike ndaj Ukrainës, por në të njëjtën kohë është fuqimisht pro-perëndimor. Sondazhet tregojnë se plani për të mbajtur shpenzimet e mbrojtjes në nivelin 2% të PBB-së përputhet saktësisht me pikëpamjet e mbështetësve të saj.

Megjithatë personaliteti përçarës i Babišit e bën partinë të varur nga partnerët më ekstremistë për të siguruar mbështetjen e nevojshme për të qeverisur. Për këtë arsye ai duhet gjithashtu të përdorë retorikën anti-establishment dhe më miqësore ndaj Rusisë të SPD-së, e cila, megjithëse kontrollon Ministrinë e Mbrojtjes, kërkon uljen edhe më tej të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2027.

më të klikuarat



Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurorin

Labirinti i errët i Edi Ramës

Shpresë për familjen Kotorri/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali

Cfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow

"Një qëndrim kritik ndaj Ukrainës ndikon gjithashtu në pozicionin e qeverisë për shpenzimet," tha Michal. Sipas tij, qasja "pro-paqe", e cila minimizon agresionin rus, e afron ANO-në "me të djathtën radikale evropiane". Megjithatë, ai thekson se Babiš "udhëhiqet nga sondazhet e opinionit" dhe përpiqet të gjejë një "ekuilibër mes dy pozicioneve polarizuese".

Kuptimi strategjik

Opozita e sheh këtë kontradiktë si pikën më të dobët të qeverisë. Martin Kupka, lider i Demokratëve Qytetarë (ODS) të qendrës së djathtë, e përshëndeti riafirmimin e angazhimit ndaj NATO-s nga Babiš, përpara se t'i drejtohej kryeministrit me pyetjen: "Kur do të hiqni qafe kolonën e pestë të Kremlinit, të cilën e sollët në qeveri dhe madje i besuat Ministrinë e Mbrojtjes?"

Megjithatë, edhe pse qeveria e udhëhequr nga ODS, e cila ishte në pushtet nga viti 2021 deri në vitin 2025, ofroi mbështetje të fuqishme për Ukrainën, as ajo dhe as paraardhëset e saj nuk arritën të përmbushnin objektivin e NATO-s për shpenzimet e mbrojtjes.

"Partnerët tanë mund të jenë të pakënaqur me këtë qasje ndaj shpenzimeve, por ky është realiteti i situatës politike në vendin tonë", tha për DW Andor Šándor, analist i mbrojtjes dhe ish-komandant i Shërbimit Ushtarak Sekret të Republikës Çeke.

Megjithatë, ai shtoi se, ndonëse ritmi i ngadaltë i ritjes së shpenzimeve për mbrojtjen "nuk është ideal", problemi më i madh është mungesa e një vizioni strategjik të qartë lidhur me madhësinë dhe rolin që duhet të ketë ushtria në të ardhmen./DW

republika Çeke slovenia shqipëria

Sondazh

Poll

Beta

28 Shtator 2026, 08:16

VIDEO/ Moti ekstrem godet Indinë dhe Nepal, 68 persona humbin jetën

Pamje NEPAL- Shirat e rrëmbyeshëm dhe rrëshqitjet e dheut kanë shkaktuar të paktën 56 viktima në Indi dhe 12 në Nep...

VIDEO/ Tension i ri në Jemen, Huthitë raportojnë dhjetëra vdekje nga sulmet saudite dhe kërcënojnë me hakmarrje

Beta

28 Shtator 2026, 07:56

E djathta ekstreme po forcohet në Francë/ Partia e Le Pen fiton një grup parlamentar në Senat për herë të parë

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 07:52

Arrestohet Riccardo Bossi, djali i themeluesit të Legas dhe dënohet me 5 vite e 9 muaj burg

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 07:43

Konflikti në Lindjen e Mesme/ Hezbollahu: Izraeli dështoi të thyejë rezistencën në Liban

[Bota](#)

27 Shtator 2026, 22:35

[Bota](#)

27 Shtator 2026, 22:23

Venezuela liron të burgosur politikë, opozita kërkon zgjedhje të lira

Delcy Rodriguez VENEZUELA- Autoritetet në Venezuelë kanë liruar një numër të konsiderueshëm të të burgosurve p...

Deklarata e Obamës për gratë në pushtet, Trump: Mendoj se janë të mrekullueshme, por kjo është qesharake

[Bota](#)

27 Shtator 2026, 22:00

Përshkallëzohet përplasja Izrael-Turqi, Netanyahu përgatit çështje kundër Erdoganit në Hagë

[Bota](#)

27 Shtator 2026, 21:55

**Aleksandër Vuçiç jep dorëheqjen, mban
fjalimin e fundit si president i Serbisë:
Lufta sapo ka filluar!**

Balo

27 Shtator 2026, 20:03

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.